

Vendim nr. 233 datë 24.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 24.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 23 (B) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BUJAR MULLARAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1678, datë 08.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe i çdo akti pasues, për shkak të cenimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 42, 49 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 45 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Bujar Mullaraj ushtron detyrën “Inspektor i Parë” në Sektorin e Kontrollit Tatimor në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve (DRT) Tiranë. Drejtoria e Kontrollit Tatimor, me shkresën nr. 49692, datë 22.07.2016, ka kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e kontrollit në një subjekt tatimor. Në përfundim, për shkak se ka vlerësuar se gjatë ushtrimit të kontrollit tatimor janë kryer shkelje të theksuara dhe të pajustificuara nga kërkuesi, drejtori i DRT-së, Tiranë, me shkresën nr. 49692 prot., datë 26.07.2016, ka propozuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij. Me vendimin nr. 660 prot., datë 27.09.2016, Komisioni Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) ka vendosur si masë disiplinore ndaj kërkuesit mbajtjen e 1/3-ës të pagës së plotë për një periudhë prej gjashtë muajsh.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vendim kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 660 prot, datë 27.09.2016 të Komisionit Disiplinor në DPT, për rrjedhojë anulimin e masës së dhënë ndaj tij.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 564, datë 20.02.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë duke shfuqizuar aktin administrativ, vendimin e Komisionit Disiplinës në DPT dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 615 (86-2020-896) datë 21.09.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 564, datë 20.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke rrëzuar kërkesëpadinë. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1678, datë 08.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi në të nuk ngrihen shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Sipas atij kolegji, është detyrë e palës rekursuese të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore, duke argumentuar se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material ose procedural dhe përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit dhe nëse shkaqet ligjore nuk arrihen të parashtrohen dhe të argumentohen sipas kërkesave ligjore, Gjykata e Lartë është e detyruar të vendosë mospranimin e rekursit.

6. Në datën 26.06.2025 kërkuksi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 është regjistruar në datën 30.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuksit

7. **Kërkuksi** ka pretenduar se janë cenuar:

7.1. *Neni 42 i Kushtetutës*, për shkak të mungesës së një procesi të rregullt dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore.

7.2. *Neni 17 i Kushtetutës*, për shkak të shkeljes së parimit të proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.

7.3. *Neni 49 i Kushtetutës*, për shkak të cenimit të së drejtës për të ushtruar funksionin publik dhe të reputacionit profesional.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji vëren se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar në ankimin kushtetues individual, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues

individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

11. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 26.06.2025, kurse vendimi gjyqësor që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, është i datës 08.04.2024. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri legjitimiteti, në ankimin kushtetues kërkuesi ka pretenduar se ai ka marrë dijeni rastësisht për vendimin e Gjykatës së Lartë, pas gati 1 viti nga shpallja e tij, vetëm kur i ka dërguar asaj gjykate kërkesë për informacion për të ditur se çfarë po ndodhte me çështjen. Po sipas kërkuesit, edhe pse ai ka vënë në dijeni atë gjykatë për emërimin e një përfaqësuesi tjetër ligjor dhe për të dhënat e tij të kontaktit, përfshirë ato elektronike, Gjykata e Lartë nuk e ka informuar as për vendimin, as për zbardhjen e tij.

12. Në lidhje me momentin e marrjes dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë, nga i cili fillon të ecë afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në disa çështje kundër Shqipërisë ka konstatuar shkelje të nenit 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në drejtim të aksesit në Gjykatën Kushtetuese, aty ku afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është përllogaritur nga data e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur ai i është njoftuar kërkuesit (shih *Supergrav Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 20702/18, datë 09.05.2023, §§ 17-31). Në vlerësimin e asaj gjykate: “Gjykata Kushtetuese nuk sqaron se në çfarë mënyre një palë mund të paraqesë prova pozitive për datën e njoftimit të parë ose pse një palë e vetme duhet të mbajë barrën e provës në këtë aspekt. Gjykata konsideron se i takon, së pari, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve” (shih *Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 14.01.2025, § 13).

13. Kolegji vëren se bashkëlidhur ankimit kushtetues individual kërkuesi ka paraqitur një kopje të postës elektronike (*e-mail*) të datës 10.05.2024, me të cilën i është dërguar nga

administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë vendimi i Kolegjit Administrativ objekt i këtij ankimi. Po bashkëlidhur ankimit kushtetues kërkuesi ka paraqitur edhe një deklaratë, në të cilën ai pranon se vendimi i Gjykatës së Lartë i është dërguar në formë jozyrtare, përmes postës elektronike të datës 10.05.2024, por se nuk është shoqëruar me udhëzime të qarta ligjore për mënyrën e tërheqjes fizike të atij vendimi apo për pasojat që lidhen me afatin për të paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese. Po sipas kësaj deklarate, vetëm pas kërkesës së kërkuetit dhe kontaktit me sekretarinë e Gjykatës së Lartë, atij i është bërë me dije se vendimi mund të tërhiqej fizikisht pranë ambienteve të asaj gjykate. Sipas kërkuetit, vonesa në paraqitjen e kërkesës është e justifikuar për shkak të mungesës së një njoftimi zyrtar e të qartë në përputhje me parimet e sigurisë juridike dhe të drejtën për proces të rregullt.

14. Kolegji, në situatën që njoftimi elektronik është parashikuar si një nga format e komunikimit të akteve sipas dispozitave procedurale, si dhe në situatën që vetë kërkuesi ka konfirmuar se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues, i është njoftuar në datën 10.05.2024, vlerëson se kjo datë është momenti në të cilin kërkuesi ka marrë dijeni efektivisht për përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar dhe shkaqet për të cilat është vendosur mospranimi i rekursit të tij, pra nga i cili ka filluar të ecë afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur dukshëm jashtë afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.